

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10304, DATË
15.7.2010 “PËR SEKTORIN MINERAR NE REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Në kuadër të reformës së derregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen.

Me anë të këtyre ndryshimeve, synohet të arrihet: (a) Reduktim i barrierave administrative; (b) Liberalizim i tregut; dhe (c) Përmirësim i mëtejshëm i klimës së biznesit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2019.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Neni 5, i Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se *“Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj,*

ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”.

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.

Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se veprimtaritë studimore projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga subjektet e çertifikuara për këtë qëllim. Çertifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat fizikë, të regjistruar si të tillë, që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Kjo veprimtari mund të kryhet dhe nga persona juridikë të cilët kanë të punësuar individë të certifikuar. Gjithashtu, subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari do të kenë detyrimin të regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarisë së studimore projektuese në fushën minerare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutë së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë acquis specifik të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Përsa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.

Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se veprimtaritë studimore projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga subjektet që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e veprimtarive studimore projektuese në fushën minerare dhe që kanë të punësuar individë të certifikuar. Çertifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat fizikë, të regjistruar si të tillë, që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Gjithashtu, subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari do të kenë detyrimin të regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarisë së studimore projektuese në fushën minerare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 17869 prot, datë 04.10.2018, është shprehur në parim dakord për projektligjin.

Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. 10099 prot, datë 08.10.2018, ka dërguar komentet e mëposhtme:

Komenti i parë konsiston në rishikimin e mospërputhshmërisë së përdorimit të termit “autorizim” në titullin e seksionit të dytë” dhe termit “çertifikimi” i veprimtarisë studimore projektuese në nenin 33. Lidhur me këtë koment sqarojmë se përdorimi i termit “autorizim” i referohet nenit 32 të ligjit 10304 dhe konkretisht autorizimit të tregtimit të grupit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, ndërsa termi “çertifikim” lidhet me veprimtarinë studimore projektuese. Në këtë kuptim, nuk mund të bëjmë një unifikim të këtyre termave, pasi përdoren për veprimtari të ndryshme.

Komenti i dytë lidhet me qartësimin se si dhe nga kush do përcaktohet aftësia teknike dhe përvoja e nevojshme në certifikimin e subjekteve. Lidhur me këtë koment sqarohet se aftësitë teknike dhe përvoja e nevojshme për certifikimin e këtyre subjekteve përcaktohen në Vendimin nr. 441, datë 16.6.2011, të Këshillit të Ministrave.

Komenti i tretë lidhet me parashikimin e një dispozite kalimtare, nëse subjektet e licencuara tashmë për këtë veprimtari duhet të certifikohen sërish apo licencat aktuale ruajnë vlerën e tyre. Lidhur me këtë koment sqarohet se nuk është e nevojshme që subjektet tashmë të licencuara për këtë veprimtari të certifikohen sërish, pasi licencat aktuale do të ruajnë vlerën e tyre. Nga ana jonë është bërë reflektimi i dispozitës tranzitore në projektligj.

Pas ripunimit të projektligjit dhe relacionit, si dhe dhënies së argumenteve mbi komentet e dërguara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, paketa projektligj-relacion u ridërgua për mendim tek kjo e fundit, e cila ka dërguar komentet e mëposhtme:

Komenti i parë konsiston në riformulimin e titullit të projektligjit: “Për disa ndryshime dhe shtesa ...[..]”. Lidhur me këtë koment sqarohet se është marrë konsideratë nga ana jonë duke bërë reflektimin përkatës.

Në komentin e dytë Ministria e Drejtësisë shprehet se në fjalinë e dytë, të nenit 2 të projektligjit, parashikohet se certifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat fizikë, të regjistruar si të tillë, ndërkohë nuk është e qartë nëse mund të certifikohen edhe personat juridikë për kryerjen e kësaj veprimtarie. Gjithashtu për sa i përket komentit të Ministrisë së Drejtësisë, se si dhe nga kush do të përcaktohet aftësia teknike dhe përvoja e nevojshme, në relacionin shoqërues argumentohet që këto çështje rregullohen në vendimin nr. 441, datë 16.06.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve të certifikimit e të licencimit, të dokumenteve shoqëruese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave, për licencimin e veprimtarisë studimore-projektuese në veprimtaritë minerare”, vendim i cili ka si bazë ligjore pikërisht pikën 4 të nenit 33 në fuqi të ligjit nr. 10304/2010, i cili propozohet të ndryshohet në tërësi në këtë projektakt. Me miratimin eventual të këtij projektligji, praktikisht VKM-ja nr. 441/2011 nuk ka më fuqi ligjore. Në këtë aspekt, duhet të përcaktohet në këtë projektligj ose të referohet në ndonjë akt tjetër se cili do të jetë organi që do të vlerësojë aftësitë teknike dhe përvojën e nevojshme të subjekteve.

Duke vlerësuar komentin e lartpërmendur, nga ana jonë është bërë riformulimi i nenit 2 të projektligjit si më poshtë:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

“Neni 33 ndryshohet si vijon:

“Neni 33

Veprimtaritë studimore-projektuese

1. Veprimtaritë studimore-projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga persona fizik ose persona juridikë, që kanë të punësuar persona të certifikuar në veprimtarinë studimore-projektuese në fushën minerare. Subjektet që kërkojnë të certifikohen detyrohen të regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e veprimtarive studimore projektuese në fushën minerare.
2. Çertifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Belinda Balluku

Konceptoi: A. Korita
A. Naumi
Miratoi: M. Hasalami
E. Karakaçi
Konfirmoi: E. Ahmeti